

VENDIM
Nr.517, datë 26.7.2006

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË ISH-NËNOFICERIT NAMIK
GJOLENA DHE ISH-USHTARIT PROFESIONIST ARDIAN HANAJ, TË VRARË NË KRYE TË
DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 28 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie ndihme financiare, prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, familjes së ish-nënoficerit Namik Gjolea, dhe një ndihmë financiare, prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, familjes së ish-ushtarit profesionist Ardian Hanaj, të vrarë në krye të detyrës.
 2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
 3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha